



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 18 tetor 2021
Nr. Ref.:RK1870/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI38/21

Parashtrues

MS FINANCE L.L.C me pronar Muhamet Shabani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.
4311/2019, të 18 marsit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga MS FINANCE L.L.C me seli në fshatin Kmetovc-Komuna e Gjilanit, me pronar Muhamet Shabani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdyl Jerliu nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 4311/2019, të 18 marsit 2020.
3. Nga shkresat e lëndës, përkatësisht fletëkthesa vërehet se me 12 qershor 2020 është tentuar t'i dorëzohet parashtruesit të kërkesës Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 4311/2019, i 18 marsit 2020 së bashku me (i) Urdhrin e 1 qershorit 2020; (ii) Urdhri për shitje i 31 korrikut 2019; dhe (ii) pasqyra e shpenzimeve të procedurës përmbartimore. Megjithatë, në fletëkthesë shkruan se *"pala gjendet në Zvicër"*.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 22 shkurt 2021, Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), e të cilën kjo e fundit e pranoi më 13 janar 2021.
7. Më 26 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 2 mars 2021, Gjykata (i) e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës; dhe (ii) kërkoi nga përfaqësuesi dorëzimin e autorizimit që dëshmon se po e përfaqëson parashtruesin e kërkesës pranë Gjykatës; dhe (iii) fletëkthesën që dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi Aktvendimin e Gjykatës se Apelit Ac.nr.4311/2019 të 18 marsit 2020.

9. Më 22 mars 2021, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës përmes postës elektronike bashkëngjiti 1. Autorizimin përkatës dhe dokumente e pretendime tjera. Faqen e dytë dhe të tretë të një ankese.
10. Më 24 mars 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të bashkëngjisin fletëkthesën se kur ka pranuar parashtruesi vendimin e kontestuar. Meqenëse Gjykata e Apelit nuk kishte dhënë përgjigje lidhur me kërkesën e 24 marsit 2021, më 6 prill 2021, Gjykata kërkoi përsëri bashkëngjitjen e fletëkthesës.
11. Më 13 prill 2021, Gjykata e Apelit përmes postës elektronike, njoftoi Gjykatën që ekspeditimi i vendimeve bëhet në *"gjykatën themelore nga e cila gjykate ka ardhur lënda"*.
12. Më 14 prill 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike, bashkëngjitjen e fletëkthesës.
13. Më 20 prill 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike njoftoi Gjykatën që fletëkthesa e lëndës gjendet tek Përmbaruesi Privat Përparim Xhelili në Gjilan, ose Gjykata Themelore në Gjilan.
14. Rrjedhimisht, Gjykata më 23 prill 2021, njoftoi Përmbaruesin Privat Përparim Xhelili (në tekstin e mëtejme: Përmbaruesi Privat) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai (i) dosjen e plotë (originale) të lëndës dhe (ii) të paraqesë komente, nëse ka, lidhur me rastin.
15. Më 14 maj 2021, Gjykata pranoi nga Përmbaruesi Privat Përparim Xhelili (i) dosjen e plotë të lëndës; dhe (ii) komentet lidhur me rastin.
16. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
17. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
18. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH38/21, emëroi gjyqtarin Safet Hoxha si anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.

19. Me 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të emërohej kryesuese në Kolegjet shqyrtuese në rastet kur ajo ishte emëruar anëtare e Kolegjit.
20. Më 14 qershor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për komentet e dorëzuara nga Përmbaruesi Privat Përparim Xhelili. Gjykata po ashtu kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të njoftojë Gjykatën se (i) si është njoftuar dhe (ii) kur është informuar me përmbajtjen e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.4311/2019 të 18 marsit 2020, meqenëse kundër të njëjtit Aktvendim të Gjykatës së Apelit ai ka ushtruar iniciuar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë tek Prokurori i Shtetit.
21. Më 22 qershor 2021, parashtruesi dorëzoi përgjigje në Gjykatë.
22. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
23. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin KSH 38/21, duke e zëvendësuar Kryetaren paraprake Arta Rama-Hajrizi në rolin e saj si kryesuese në këtë Kolegj shqyrtues.
24. Më 24 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedura e pajtimit gjyqësor

25. Sipas shkresave të lëndës, rezulton që parashtruesi i kërkesës i kishte borxh kompanisë I, për shkak se e njëjta ka kryer punë në llogari të parashtruesit të kërkesës, përmes përgatitjes së terrenit bazë për fillimin e ndërtimeve, një shumë prej 17.826,00 Euro, shumë kjo e cila nuk ishte paguar nga parashtruesi i kërkesës. Rrjedhimisht, kompania I, kishte iniciuar propozim për sigurimin e kërkesëpadsisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamentin për Çështje Ekonomike me propozim për caktimin e masës së sigurisë duke kërkuar t'i ndalohet të paditurit-kundërshtarit të sigurimit [parashtruesit të kërkesës], të tërheqë mjetet financiare në të gjitha llogaritë e tija rrjedhëse në gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe t'i ndalohet t'i tjetërsojë, të disponojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe me asetet e saja deri në vlerën prej 17.826.00 Euro.
26. Më 26 tetor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore në Prishtinë), mbanë seancën për shqyrtimin përgatitor, në të cilin marrim pjesë kompania I dhe parashtruesi i kërkesës. Gjykata Themelore në Prishtinë nxjerr Aktvendimin III.EK.nr. 268/2018, me të cilin konstaton se (i) kompania I tërheqë propozimin për masë të përkohshme dhe (ii) se Gjykata Themelore merr Pajtim Gjyqësor

konform nenit 411 paragrafi 2, 416 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK) përmes të cilit detyrohet parashtruesi i kërkesës që kompanisë I, t'ia paguajë në emër të borxhit shumën prej 16,000.00 Euro, në tri këste, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 500 Euro dhe 100 Euro taksën për padi.

27. Parashtruesi i kërkesës, sipas shkresave të lëndës, nuk paguan këstin e parë siç është dakorduar në pajtim gjyqësor. Rrjedhimisht, kompania I, inicioi procedurën përmbartimore.

Procedura përmbartimore

28. Më 31 dhjetor 2018, kompania I në cilësinë e kreditorit kërkon propozim për përmbartim kundër parashtruesit të kërkesës në cilësinë e debitorit, bazuar në Pajtimin Gjyqësor të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë III.EK.nr. 268/2018 i 26 tetorit 2018, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk ka përmbushur obligimet e tij. Në Propozimin e tij për përmbartim kompania I kërkon të Caktohet Përmbartimi dhe të obligohet parashtruesi i kërkesës (i) që t'ia paguajë këstin e parë dhe kamatën ligjore prej 8%; (ii) të paguajë shpërblimin e avokatit për përpilimin e propozimit në shumën prej 156 Euro, nën kërcënimin e dhunshëm dhe atë duke kërkuar bllokimin e të gjitha llogarive bankare në për bankat komerciale në emër të parashtruesit të kërkesës. Kompania I në rast se nuk ka mjete propozon: (i) Regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme; ose në rast se nga këto të fundit nuk mund të realizohet shuma, atëherë (ii) shënimin e përmbartimit në librin publik të palujtshmërive, me përcaktimin e vlerës së palujtshmërisë të cilat janë në emrin e debitorit, me shitjen e palujtshmërisë që janë në emrin e debitorit.
29. Më 31 dhjetor 2018, Përmbartuesi Privat lëshon Urdhrin përmbartimor P.nr.543/18.
30. Meqenëse nuk ishte parashtruar prapësim kundër Urdhërit Përmbartimor P.nr.543/18 të 31 dhjetorit 2018, ky Urdhër Përmbartimor u bë i plotëfuqishëm me 24 janar 2019.
31. Me 30 janar 2019, Përmbartuesi Privat bën kërkesë për informatë dhe ndalesë për bartjen e pronës tek personat e tretë për "MS FINANCE L.L.C" me seli në Gjilan [parashtruesit të kërkesës], tek Drejtoria e Gjeodezisë Pronës dhe Kadastrit në Gjilan.
32. Më 6 shkurt 2019, kompania I parashtron një Parashtrësë për Zgjerimin e Propozimit për përmbartim, duke llogaritur edhe shumën e kështit të dytë, i cili nuk ishte paguar, e cila së bashku me këstin e parë të pa-paguar kishte arritur shumën prej 11,000.00 Euro.
33. Më 6 shkurt 2019, Përmbartuesi Privat, përmes shkresës së titulluar "Lënda: Konkluzion" njofton parashtruesin e kërkesës se i autorizuar i kreditorit ka ushtruar parashtrësë për zgjerimin e propozimit për përmbartim.

34. Më 25 mars 2019, Përmbaruesi Privat merr Urdhrin Përmbarimor P.nr.543/18, **I.** Urdhëron Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Gjilan që të bëjë Caktimin e shënimit të përmbarimit në librin publik të palujtshmërive të evidentuara në kadastër me nr. [...] P-70403033-02444-9, P-70403033-02444-10, P-70403033-02444-11, [...] P-70403033-02444-18, [...] në vendin e quajtur Kmetoc-Gjilan **II.** shënimi i përmbarimit caktohet për pagesën e borxhit kryesor për përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga pika I e dispozitivit të Titullit Ekzekutiv- Pajtimit Gjyqësor të Gjykatës Themelore, me të cilën obligohet parashtruesi i kërkesës që për shkak të mos-pagimit të borxhit, t'ia paguajë shumën prej 11,000.00 Euro; **III.** me shënimin e përmbarimit në patundshmërinë e parashtruesit të kërkesës kreditori [kompania I] e fiton të drejtën që borxhin e lartpërmendur, t'ia realizojë në patundshmërinë e lartpërmendur, dhe që parashtruesi i kërkesës ka për detyrë t'ia njoh kreditorit të drejtën e realizimit me prioritet të borxhit.
35. Më 2 maj 2019, Përmbaruesi Privat nxjerr Konkluzion P.nr.543/18, me të cilin caktohet eksperti H.I, që të bëjë ekspertizën për llogaritjes e parcelës P-70403033-02444-10 në sipërfaqe prej 248 m2, dhe parcelës P-70403033-02444-18 në sipërfaqe prej 59 m2.
36. Më 8 maj 2019, eksperti H.I, kishte vlerësuar parcelat P-70403033-02444-10 dhe P-70403033-02444-18, me vlerën prej 95,975.00 Euro.
37. Më 13 maj 2019, Përmbaruesi Privat në lëndën P.nr.543/18, lëshon Konkluzion P.nr.543/18, për shitjen e paluajtshmërisë në ankandin e I-rë publik verbal përmes të cilit **I.** Cakton seancën e parë të ankandit publik verbal për shitjen e paluajtshmërisë me nr. P-70403033-02444-11 në sipërfaqe prej 207 m2 ZK Gjilan dhe parcelën P-70403033-02444-18 me sipërfaqe 59 m2 ZK Gjilan; **II.** Vlera e paluajtshmërisë 95,975.00 Euro; **III.** Vlera e paluajtshmërisë si në pikën II, u përcaktua sipas marrëveshjes hipotekare; **IV.** Në seancën e parë të ankandit, paluajtshmëria nuk mund të shitet në çmimin që është më i ulët se 50% së vlerës së përcaktuar në pikën II, dhe ofertat më të vogla se 50% nuk do të shqyrtohen; **V.** Në qoftë se paluajtshmëria nuk shitet në seancën e parë, organi përmbarues e cakton seancën e dytë brenda 15 deri 30 ditë, dhe në të cilën seancë paluajtshmëria nuk mund të shitet për çmimin më të ulët se 1/3 e vlerës; **VI.** Në ankand marrin pjesë vetëm personat që kanë depozituar garancionin. **VII.** Ofertuesi, i cili caktohet blerës, duhet të depozitojë shumën e tërësishme të çmimit të blerjes; **VIII.** Blerës nuk mund të jenë personat sipas nenit 239 paragrafi 2 i LPP-së; **IX.** Konkluzioni do shpallet në tabelën e përmbajtjes dhe t'iu dërgohet palëve në procedurë dhe organeve kompetente; **X.** Drejtoritë përkatëse të Komunës janë të obliguara ta vendosin konkluzionin në tabelë; dhe **XI.** Seanca e parë e ankandit publik verbal për paluajtshmërinë e pikës I. Mbahet me 17 qershor 2019 në zyrën e Përmbaruesit Privat.
38. Me 17 qershor 2019, u mbajt seanca e parë të ankandit publik verbal në të cilën u shpallën lëndë e ankandit ngastrat P-70403033-02444-11 dhe P-70403033-02444-18. Në këtë seancë mungoi debitori [parashtruesi i kërkesës], edhe pse ishte i njoftuar. Në seancë poashtu munguan ofertuesit, rrjedhimisht, kreditori propozoi seancën e dytë të ankandit publik verbal më 16 korrik 2019.

39. Me 1 korrik 2019, (Gjykata vëren se ka një gabim teknik sepse në faqen e parë shkruan 13 maj 2019, ndërsa në faqen e fundit 1 korrik 2019), Përmbaruesi Privat lëshon Konkluzion P.nr.543/18, për shitjen e paluajtshmërisë në ankandin e II-të publik verbal përmes të cilit: **I.** Cakton seancën e dytë të ankandit publik verbal për shitjen e paluajtshmërisë me nr. P-70403033-02444-11 në sipërfaqe prej 207 m² ZK Gjilan dhe parcelën P-70403033-02444-18 me sipërfaqe 59 m² ZK Gjilan; **II.** Vlera e paluajtshmërisë 95,975.00 Euro; **III.** Vlera e paluajtshmërisë si në pikën II, u përcaktua sipas marrëveshjes hipotekare; **IV.** Në seancën dytë të ankandit të shitjes paluajtshmëria nuk mund të shitet në çmimin që është më i ulët se 30% së vlerës së përcaktuar në pikën II, dhe ofertat më të vogla se 30% nuk do të shqyrtohen; **V.** Në qoftë se paluajtshmëria nuk shitet në seancën e dytë, me propozimin e kreditorit organi përmbarues merr vendim që paluajtshmëria t'i dorëzohet kreditorit duke kaluar në pronësi të tij, me ç'rast kërkesa do konsiderohet e përmbushur në tërësi; **VI.** Në ankand marrin pjesë vetëm personat që kanë depozituar garancionin. **VII.** Ofertuesi, i cili caktohet blerës, duhet të depozitojë shumën e tërësishme të çmimit të blerjes; **VIII.** Blerës nuk mund të jenë personat sipas nenit 239 paragrafi 2 i LPP-së; **IX.** Konkluzioni do shpallet në tabelën e përmbajtjes dhe t'iu dërgohet palëve në procedurë dhe organeve kompetente; **X.** Drejtoritë përkatëse të Komunës janë të obliguara ta vendosin konkluzionin në tabelë; dhe **XI.** Seanca e dytë (Gjykata vëren se ka një gabim teknik se do duhej të ishte seanca e dytë) e ankandit publik verbal për paluajtshmërinë e pikës I. mbahet me 22 korrik 2019 në zyrën e Përmbaruesit Privat.
40. Me 24 korrik 2019, Përmbaruesi Privat nxjerr Konkluzion P.nr.543/18, për shtyrjen e ankandit II-të publik sepse gjatë mbajtjes së ankandit është vërejtur gabimi në parcela P-70403033-02444-11 dhe P-70403033-02444-18, ku parcelat në fjalë nuk kanë lidhje mes vete. Lidhur me ndërrimin e parcelave, Përmbaruesi Privat kishte arsyetuar se numrat e parcelës dhe shtëpisë nuk përputhen, sepse shtëpia është ndërtuar në parcelën nr. P-70403033-02444-11 dhe P-70403033-02444-18, mirëpo parcela e dytë nuk është në emër të kompanisë [parashtruesit të kërkesës], ndërsa parcela tjetër është e kompanisë, por nuk ka lidhje me shtëpinë. Rrjedhimisht, Përmbaruesi Privat, bëri zëvendësimin e parcelave P-70403033-02444-11 dhe P-70403033-02444-18, me parcelën P-70403033-02444-9 në sipërfaqe prej 312 m². Për pasojë, ankandi i dytë publik i shitjes së paluajtshmërisë së hipotekuar u shty me 31 korrik 2019.
41. Me 25 korrik 2019, nxjerr Konkluzion P.nr.543/18, me të cilin caktohet eksperti H.I, që të bëjë ekspertizën për llogaritjes e parcelës P-70403033-02444-9 në sipërfaqe prej 312 m².
42. Me 26 korrik 2019, eksperti H.I, kishte vlerësuar parcelën P-70403033-02444-9, me vlerën prej 96,200.00 Euro.
43. Me 31 korrik 2019, u mbajt ankandi i dytë publik verbal (Gjykata vëren se ekziston një gabim teknik sepse në Procesverbal në tekst lart shkruan "Shitja e paluajtshmërisë në ankandin e I-rë publik verbal", ndërsa në tekst i referohet tërë kohën "ankandi i dytë verbal"), në të cilin morën pjesë përmbaruesi,

- kompania I, dhe ofertuesi. Parashtruesi i kërkesës, mungoi. Përmbaruesi Privat shpalli lëndën për ankandin publik- ngastrën kadastrale P-70403033-02444-9 në sipërfaqe prej 312 m² në emër të “Ms Finance” L.L.C [parashtruesit të kërkesës].
44. Më 31 korrik 2019, Përmbaruesi Privat nxori Urdhër P.nr.543/18, përmes të cilit (i) ia kishte shitur ofertuesit M.A, paluajtshmërinë P-70403033-02444-9 në sipërfaqe prej 312 m, në shumën prej 32.138,00 Euro; (ii) i dorëzohet blerësit M.A, paluajtshmëria sipas pikës i; (iii) urdhërohet Zyra Komunale e Kadastrit në Gjilan të bëjë regjistrimin e të drejtës së pronës në regjistrin e të drejtave të pronave të paluajtshme.
 45. Më 9 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës parashtron ankesë kundër Urdhërit për shitje P.nr.543/2018 të 31 korrikut 2019. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij, e konsideron Urdhrin për shitje P.nr.543/2018 të pa drejtë ngase konsideron se nuk është ftuar me rregull për mbajtjen e ankandit publik duke pasur parasysh që jeton në Republikën e Serbisë e edhe në Zvicër dhe thekson se përmbaruesi asnjëherë nuk ka arritur të dorëzojë në mënyrë të rregullt shkresat me çka ka shkaktuar dhe pasoja procedurale. Së dyti, parashtruesi i kërkesës thekson se vlera e borxhit prej 11.000, 00 Euro, e cila po të krahasohet me vlerën e paluajtshmërisë së shitur del diferencë prej 100.000,00 Euro, e që parashtruesi i kërkesës thekson se për të njëjtën po të ishte ftuar me rregull, nuk do kishte lejuar të ndodhte ankandi. Për më tepër, parashtruesi thekson se paluajtshmëria P-70403033-02444-9 i takon Kompanisë A.
 46. Nga shkresat e lëndës dhe një palë e tretë e interesuar [Kompania A] kishte parashtruar ankesë kundër Urdhërit për shitje P.nr.543/2018 të 31 korrikut 2019. Më 13 gusht 2019, pala e tretë e interesuar [Kompania A], dorëzoi parashtrësë për tërheqjen e ankesës.
 47. Më 28 gusht 2019, Përmbaruesi Privat kishte dorëzuar “Deklaratë për mbarëvajtjen e procedurës përmbarimore” në Gjykatën e Apelit. Në këtë shkresë Përmbaruesi Privat, kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës ka refuzuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.543/18 të 31 dhjetorit 2018, dhe për më tepër është njoftuar edhe përmes aplikacionit “Viber”, ku përkundër paralajmërimeve, se do fillohet me caktimin e ankandëve ai nuk iu është përgjigjur ftesës. Përmbaruesi Privat duke iu referuar pretendimeve lidhur me mos-lajmërimin me rregull për seanca theksoi se janë të pavërteta, marrë parasysh që kompania parashtruesit është subjekt juridik dhe ka selinë e saj, dhe për më tepër parashtruesi i kërkesës përpos me postë është njoftuar edhe me “Viber”.
 48. Më 18 mars 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit Ac.nr.4311/2019 (i) refuzoi si të pathemeltë ankesën e debitorit [parashtruesit të kërkesës] dhe vërtetoi Urdhrin për Shitje P.nr.543/2018 të 31 korrikut 2019; (ii) hodhi poshtë si të palejuar ankesën e personit të tretë [Kompanisë A], e ushtruar kundër Urdhërit për shitje P.nr.543/2018 të 31 korrikut 2019, sepse Kompania A kishte parashtruar parashtrësë me të cilën është tërhequr ankesa e saj. Gjykata e Apelit, arsyetoi se kundër Urdhërit për Shitje P.nr.543/2018 parashtruesi i kërkesës ka ushtruar ankesë duke mos i cekur pretendimet ankimore. Sa i përket pretendimeve për Urdhrin e shitjes, Gjykata e Apelit, fillimisht theksoi se Urdhri

për shitje P.nr.543/2018 është i drejtë konform dispozitës 222 të LPP-së, sepse pasi kryhet procedura për përcaktimin e vlerës së paluajtshmërisë, organi përmbaues jep konkluzion për shitjen e paluajtshmërisë në të cilën cakton vlerën, mënyrën, kushtet, kohën dhe vendin e shitjes nëse shitja bëhet me ankand publik. Gjykata e Apelit poashtu theksoi se organi përmbaues konform nenit 223 të LPP-së e shpall konkluzionin për shitje në tabelën e tij, dhe më pas mënyra e shitjes së paluajtshmërisë rregullohet me nenin 227 të LPP-së, përcaktohen kushtet tjera për ankandin publik verbal.

49. Së dyti, lidhur me pretendimin ankimor për çmimin e shitjes së paluajtshmërisë, Gjykata e Apelit arsyetoi se shitja e paluajtshmërisë në seancën e dytë të ankandit publik, është në përputhje me 1/3 e vlerës së paluajtshmërisë siç është vlerësuar me ekspertizën e 26 korrikut 2019 e ekspertit H.I.
50. Së treti, lidhur me pretendimin ankimor të parashtruesit të kërkesës se ai nuk ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e ankandit publik nga Përmbauesi Privat, Gjykata e Apelit bazuar në shkresat e lëndës, konkretisht fletëkthesat për dorëzim personal, theksoi se parashtruesit të kërkesës është tentuar dy herë t'i bëhet dorëzimi i konkluzioneve për mbajtjen e ankandit (i) një herë më 16 maj 2019, me ç' rast shkresa është kthyer sepse ai nuk është gjendur aty; dhe (ii) më 20 maj 2019, kur është refuzuar pranimi pa ndonjë arsye dhe që në rastin konkret, Gjykata e Apelit e konsideroi se dorëzimi është realizuar me rregull konform nenit 112 të LPK-së.
51. Më 1 qershor 2020, Përmbauesi Privat bie Urdhër P.nr.543/2018 me të cilin konstaton se (i) është paguar në tërësi borxhi, dhe (ii) urdhërohet Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër në Gjilan të lirojë nga caktimi i shënimit të gjitha pronat që gjenden në emër të parashtruesit të kërkesës dhe të evidentohet paluajtshmëria P-70403033-02444-9 në emër të blerësit M. A.
52. Me 12 qershor 2020 është tentuar t'i dorëzohet parashtruesit të kërkesës Aktvendimi të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 4311/2019, i 18 marsit 2020 së bashku me (i) Urdhërin e 1 qershorit 2020; (ii) Urdhri për shitje i 31 korrikut 2019; dhe (iii) pasqyra e shpenzimeve të procedurës përmbaimore. Në fletëkthesë shkruan se *"pala gjendet në Zvicër"*.
53. Më 14 dhjetor 2020, sipas shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar dosjen e plotë tek Përmbauesi Privat.
54. Më 24 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës parashtron propozim për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar Aktvendimit Ac.nr.4311/2019 të Gjykatës së Apelit, pretendon shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij u ankua për (i) faktin që Përmbauesi Privat nuk kishte marrë Urdhër përmbaimor plotësues, lidhur me shumën e këstit të dytë; (ii) Urdhër përmbaimor është përshkuar me shkelje thelbësore të nenit 182 paragrafi 1(8) të LPK-së; (iii) nuk është marrë konkluzion i ri lidhur me ndërrimin e parcelave; (iv) lidhur me marrjen e konkluzioneve, parashtruesit nuk iu është lejuar sqarimi; (v) Urdhri për shitje P.nr.543/2018 i 31 korrikut 2019, është ndërmarrë në kundërshtim me

dispozitat e LPP-së, pa marrjen e urdhrit plotësues dhe nxjerrjes së konkluzioneve lidhur me përmirësimin e numrit të parcelave objekt i shitblerjes hipotekare; dhe (vi) Në procesverbalin e ankandit P.nr.543/2018 të 31 korrikut 2019, ngastra P-70403033-02444-9 pa u marrë fare konkluzioni, i shitet personit M.A, me 1/3 e çmimit. Në fund, parashtuesi i kërkesës thekson se Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac.nr.4311/2019, nuk ka përmirësuar faktin që Përmbartuesi Privat ka zbatuar gabimisht ligjin.

55. Më 22 janar 2021, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes shkresës KMLC.nr.185/2020, gjeti se propozimi i parashtuesit të kërkesës nuk aprovet sepse *“pretendimet e cekura në propozimin tuaj nuk janë të mjaftueshme për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 247.1 pika a) dhe b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore*. Për më tepër, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit theksoi se në bazë të nenit 247 paragrafi 2 nuk mund ngrejë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Pretendimet e parashtuesit të kërkesës

56. Parashtuesi i kërkesës pretendon se përmes vendimit të kontestuar, atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës.
57. Parashtuesi i kërkesës, përkritazi me pretendimet për shkeljen e së drejtës së tij për barazi para ligjit, thekson se në rastin e tij, Përmbartuesi Privat nuk i ka trajtuar palët në procedurë njësoj, por i ka dhënë tretman të veçantë kreditorit, për çka parashtuesi i kërkesës i referohet deklaratës së përmbartuesit pranë Gjykatës së Apelit ku deklaroi që *“ti refuzojë pretendimet e debitorit, dhe ta aprovojë përgjigjen e përmbartuesit”*.
58. Parashtuesi i kërkesës, më tej, thekson *“Derisa lënda gjendet në procedurë ankimore, pastaj fakti, se eksperti vlerësues H.I, me konkluzionin e dt.02.05.2019, sipas lëndës P.nr.543/18, është obliguar të bëjë vlerësimin e parcelave P-70403033-02444-10, dhe parcelës P-70403033-02444-18, për çka i njëjti edhe bënë vlerësimin e këtyre parcelave për shumën prej 95.975.00 euro, pastaj sipas konkluzionit për shitjen e paluajtshmërisë në ankandin e parë P.nr.543/18 i dt.13.05.2019, caktohet ankandi për një parcele tjetër edhe atë P-70403033-02444-11, e cila nuk ka qenë fare objekti i vlerësimit nga eksperti.”*
59. Më tej, parashtuesi thekson se sipas Konkluzionit P.nr. 543/18 të 24 korrikut 2019, në paragrafin e fundit të arsytimit përmbartuesi thekson se është bërë gabim në ngastra, *“ashtu që në ankandin e II, do të del në shitje parcela P-02444-9, pa pruar urdhër përmbartimor të veçantë të cilën ka mundur ta atakoj debitorin”*.
60. Duke u referuar në nenin 32 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës thekson se debitorit iu është mohuar e drejta në mjetin juridik, përkundër faktit që kreditori ka bërë propozim për zgjerimin e përmbartimit me 6 shkurt 2019, dhe për çka

përmbaruesi nuk kishte marrë urdhër të ri, për të cilin parashtruesit iu është mohuar e drejta e mjetit juridik dhe *“gjithashtu nuk iu është mundësuar edhe kur janë ndërruar parcelat”*.

61. Parashtruesi i kërkesës, poashtu duke iu referuar nenit 46 të Kushtetutës, pretendon se është dëmtuar lidhur me pronën e tij, sepse iu është cenuar e drejta e pronës tij, duke marrë parasysh që Përmbaruesi Privat, ka shkelur procedurën e përmbarimit, me ç'rast ka ndërruar disa here parcelat përkatësisht parcelat P-70403033-02444-10; P-70403033-02444-11; P-70403033-02444-18, dhe në fund parcelën P-70403033-02444-9, pa marrë vendim adekuat lidhur me këto ndërrime dhe e shet të njëjtën për 1/3 e vlerës reale edhe pse sipas nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për Ndryshimin e LPP-së, paluajtshmëria në seancën e parë nuk mund të shitet me çmim më të ulët se 50%, ndërsa në rastin konkret është shitur në 1/3 e vlerës.
62. Parashtruesi i kërkesës, më tej, thekson se sipas procesverbalit P.nr. 543/18 të 31 korrikut 2019, ankandi i I-rë për shitjen e paluajtshmërisë, paluajtshmëria i shitet personit M.H, jo me çmimin 50% siç e parasheh LPP, por i shitet me 1/3 e vlerës, në shumën prej 32, 138.00 Euro. Lidhur me këtë ai thekson se edhe pse në ankandin e parë vlera e paluajtshmërisë 137 sipas ekspertit ishte 96.2000, Euro, oferta e personit M.H ka qenë më e vogël se 50%, dhe nuk është dashur të shqyrtohet fare.
63. Parashtruesi i kërkesës ka dërguar edhe dy letra përmes të cilave ka prezantuar fakte dhe pretendime shtesë. Në letrën e tij dërguar Gjykatës më 22 mars 2021, parashtruesi i kërkesës deklaroi se (i) Ankesën e dorëzuar kundër Urdhërit Përmbarimor, nuk e ka dorëzuar ai dhe pretendon se nënshkrimi i tij është i falsifikuar; dhe (ii) fletë kthesën për pranimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 4311/2019, të 18 marsit 2020, nuk e ka pranuar asnjëherë.
64. Në letrën e tij të dërguar më 22 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës poashtu theksoi se (i) ai asnjëherë nuk ka pranuar ftesë zyrtare që të marr pjesë në gjykime; (ii) është njoftuar nga personi V.M, për shitjen e paluajtshmërisë sepse e njëjta iu ishte shitur këtij të fundit nga parashtruesi, por që për shkak të situatës së pandemisë nuk ka qenë e mundur bartja e pronës; (iii) pasi është njoftuar nga personi V.M, ka filluar përpjekjet për kthimin e pronës; (iv) Avokati mbrojtës i paditësit, dhe Përmbaruesi Privat punojnë në objekt të përbashkët ndërsa Kompania I, është partnere me blerësin e paluajtshmërisë M.H, për çka këta të katërt kanë bashkëpunuar për të marrë pronën në mënyrë të jashtëligjshme.
65. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *“të vlerëson kushtetutshmërinë e Urdhërit Përmbarues P.nr. 543/18, meqenëse i njëjti është i kundërligjshëm nga fakti se debitorit iu është tjetërsuar në mënyrë të kundërligjshme prona e tij”*.

Komentet e dorëzuara nga pala e interesuar, Përmbaruesi Privat

66. Gjykata rikujton se i kishte dhënë mundësinë e paraqitjes së komenteve, Përmbaruesit Privat i cili ne shkresën e tij të datës 14 maj 2021, ka theksuar se

pas marrjes së lëndës nga kompania I, të njëjtën e ka analizuar se a po i plotëson kushtet ligjore sipas LPP-së, me ç'rast përmes Urdhërit Përmbartimor, është njoftuar debitori dhe kreditori. Duke qenë se parashtruesi i kërkesës si debitor, nuk ka parashtruar prapësim, përmbartuesi deklaroi se i ka ndërmarrë hapat tjerë procedural duke (i) bllokuar llogaritë; dhe (ii) duke caktuar shënimin mbi pronat e paluajtshme të parashtruesit të kërkesës.

67. Më tej Përmbartuesi Privat theksoi se (i) Me Aktvendimin e Zyrës Kadastrale Komunale ai nxjerr konkluzionin për ekspertizën; (ii) nxjerr konkluzionin për shitjen e paluajtshmërisë në ankandin e I-rë publik, pas ekspertizës; (iii) Debitori, edhe pse i ftuar nuk ka marrë pjesë në ankandin e I-rë të 17 qershorit 2019; (iv) Kur është caktuar ankandi i II-të më 22 korrik 2019, edhe pse debitori është njoftuar, i njëjti me shkresë kërkon afat prej 7 ditësh për të bërë pagesën, mirëpo i njëjti nuk e bën atë dhe rrjedhimisht më 31 korrik 2019 u mbajt ankandi i dytë përmes të cilit paluajtshmëria iu shit personit M.H; dhe që (v) pasi paluajtshmëria shitet, parashtruesi i kërkesës paraqet ankesë kundër Urdhrit për shitje në Gjykatën e Apelit.
68. Në fund, përmbartuesi deklaroi se parashtruesi i kërkesës ka përdorur mjetet e zakonshme dhe jashtëzakonshme juridike, dhe gjykatat e rregullta në asnjë rrethanë nuk kanë gjetur shkelje të procedurave përmbartimore.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 24
[Barazia para Ligjit]

- 1. Të gjithë janë të barabartë pa ra ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pa barabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 32
[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 22 Dokumenti përmbarues

1. Dokumente përmbaruese janë:

[...]

1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit; [...]

Neni 27 Përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor

1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.[...]

Neni 69 Prapësimi kundër vendimeve për përmbarim

[...]

4. Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.[...]

[...]

Neni 222 Konkluzioni për shitjen

1. Pasi të kryhet procedura për përcaktimin e vlerës së paluajtshmërisë, organi përmbarues jep konkluzionin për shitjen e paluajtshmërisë me të cilin cakton vlerën e paluajtshmërisë dhe mënyrën dhe kushtet e shitjes, si dhe kohën dhe vendin e shitjes, po që se shitja bëhet me anë të ankandit publik.

2. Në procedurën e përmbarimit për pjesën në bashkëpronësi nga neni 193 i këtij ligji, konkluzioni për shitjen do t'i përmbajë posaçërisht të dhënat edhe

për gjithë paluajtshmërinë, e edhe për pjesën në bashkëpronësi që është objekt përmbarimi, por edhe shënimin se organi përmbarues për objektin definitiv të shitjes do të vendosë në pajtim me dispozitat për seancën e ankandit dhe shitjes së paluajtshmërisë.

Neni 223

Publikimi i konkluzionit për shitjen

- 1. Konkluzioni për shitjen e paluajtshmërisë shpallet në tabelën e organit përmbarues, e me vendimin e organit përmbarues edhe në mënyrë tjetër përkatëse.*
- 2. Pala apo kushdo tjetër me interesa pronësore në atë pronë ka të drejtën që me shpenzimet e tij ta publikojë konkluzionin për shitjen në mjetet e informimit publik, dhe t'i njoftojë personat që merren me ndërmjetësimin në shitjen e sendeve të paluajtshme për atë konkluzion.*
- 3. Prej shpalljes së konkluzionit për shitjen në tabelën e organit përmbarues deri në ditën kur duhet të bëhet shitja e paluajtshmërisë duhet të kalojnë të paktën tridhjetë (30)ditë.*
- 4. Konkluzioni për shitjen u dërgohet palëve, personave të cilët kanë të drejtën e realizimit me prioritet të kredive, apo të drejtën e realizimit të rangut të njëjtë me kreditorin, personave që kanë të drejtën e regjistruar, ose të drejtën ligjore të parablerjes dhe organit kompetent administrativ të tatimeve.*

[...]

Neni 227

Mënyra e shitjes së paluajtshmërisë

- 1. Shitja e paluajtshmërisë bëhet me anë të ankandit publik verbal.*
- 2. Seanca për shitjen e paluajtshmërisë mbahet në ndërtesën e Gjykatës, në qoftë se organi përmbarues nuk ka caktuar vend tjetër të shitjes.*
- 3. Seanca për shitje mbahet para organit përmbarues.*

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

KREU VIII DËRGIMI I SHKRESAVE

[...]

Neni 111

111.1 Po që se personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës nuk gjendet në banesën e vet, dorëzimi bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtar i rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim, e po që se as këta nuk gjenden në banesë, shkresa do t'i jepet fqinjit, po që se pajtohet me një gjë të këtillë. Dorëzimi i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i vlefshëm. 111.2 Po që se dërgimi bëhet në vendin e punës së personit të cilit duhet t'i jepet shkresa, kurse ky person nuk gjendet aty, shkresa mund t'i

dorëzohet personit që punon në të njëjtin vend, në qoftë se ai pajtohet që ta marrë shkresën.

111.3 Nuk lejohet dorëzimi i shkresës personit i cili merr pjesë në procedurë si kundërshtar i personit të cilit duhet dorëzuar shkresa.

111.4 Personat të cilëve u është bërë dorëzimi i shkresave sipas dispozitave të sipërme të këtij neni, në vend se adresatit, kanë për detyrë që shkresën t'ia dorëzojnë këtij te fundit.

Neni 112

Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t'ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t'ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgese do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm.

Neni 113

Po që se konstatohet se personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës mungon dhe se personat e përmendur në nenin 111 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji nuk do të kenë mundësi që shkresën t'ia dorëzojnë me kohë, shkresa do të kthehet në gjykatë me një shënim në fletë dorëzimin se ku ndodhet adresati.

Neni 114

Në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës, dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Neni 115

115.1 Në qoftë se dorëzimi i shkresës personit fizik sipas dispozitave të nenit 110 dhe 113 të këtij ligji nuk është i mundshëm, komunikuesi do ta kthejë shkresën në gjykatën e cila e ka urdhëruar dërgimin. Po që se kemi të bëjmë me komunikimin nëpërmjet postës, shkresa i kthehet postës së vendbanimit të adresatit.

Në derën, përkatësisht në arkën postare të adresës së vendbanimit lehet njoftimi në të cilin tregohet vendi ku ndodhet shkresa, afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh brenda të cilit adresati duhet ta marrë shkresën, dita në të cilën lajmërimi i është dorëzuar personit që e ka pranuar dhe nënshkrimi i dorëzuesit. Në shkresën e kthyer tregohet emri i komunikuesit, shkaku për veprimin në këtë mënyrë dhe dita në të cilën lajmërimi i është lënë marrësit.

115.2 Po që se adresati nuk e merr shkresën brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh supozohet se është kryer komunikimi në ditën kur në derën, përkatësisht në arkën postare është lënë njoftimi.

115.3 Për dërgimin e kryer në mënyrën e përcaktuar në këtë nën duhet njoftuar gjykatën që e ka urdhëruar dërgimin e shkresës.

Neni 122

[Shikimi dhe përshkrimi i shkresave në dosjen e lëndës]

122.1 Palët kanë të drejtë t'i shikojnë dhe t'i përshkruajnë shkresat e dosjes së lëndës së procedurës në të cilën marrin pjesë.

122.2 Personave të tjerë, që kanë interes të arsyeshëm, mund t'u lejohet shikimi dhe përshkrimi i shkresave të veçanta të dosjes së lëndës.

122.3 Kur procedura është në zhvillim e sipër, lejen për shikim dhe përshkrim e jep gjyqtari i lëndës, kurse kur procedura ka përfunduar, kryetari i gjykatës, respektivisht punëtori në gjykatë të cilin e cakton ai.

[...]

Neni 247

247.1 Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë:

a) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore;

b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

247.2 Prokurori publik nuk mundë të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të kapërcimit të kërkesë-padisë dhe as për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

69. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

70. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

71. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”*.
72. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe shih rastin KI26/19, parashtrues *Xhavit Thaqi Pronar i kompanisë “NTP INTERBAJ”*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 tetorit 2020, paragrafi 56).
73. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

74. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht konteston specifikisht Aktvendimin Ac.nr. 4311/2019, të 18 marsit 2020 të Gjykatës Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

75. Gjykata ka parasysh që ekziston edhe shkresa KMLC.nr.185/2020 i 22 janarit 2021 e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, megjithatë, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet pretendime specifike që kanë të bëjnë me arsyet e dhëna nga Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe se si Njoftimi i kësaj të fundit për të mos paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme kishte cenuar të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës. Pretendimet e parashtruesit në kërkesën e tanishme ndërlidhen specifikisht me procedurat e përmbarimit të ndjekura nga Përmbaruesi Privat dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, dhe me pretendimet se kjo e fundit në esencë nuk ka trajtuar shkeljet e pretenduara në procedurën përmbarimore.
76. Bazuar në sa më sipër, Gjykata rikujton se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 4311/2019, ishte nxjerrë më 18 mars 2020. I njëjti vendim, siç vërtetohet nga dosja e lëndës përkatësisht fletëkthesa, është tentuar të i dorëzohet parashtruesit të kërkesës me 12 qershor 2020 së bashku me (i) Urdhrin e 1 qershorit 2020; (ii) Urdhrin për shitje i 31 korrikut 2019; dhe (ii) pasqyrën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore. Megjithatë, në fletëkthesë shkruan se “pala gjendet në Zvicër”. Parashtruesi i kërkesës, kërkesën e tij pranë Gjykatës e kishte dorëzuar më 22 shkurt 2021, dhe në pyetjen konkrete të 14 qershorit 2021, Gjykata kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të njoftojë Gjykatën se (i) si është njoftuar dhe (ii) kur është informuar me përmbajtjen e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.4311/2019 të 18 marsit 2020, por për këto pyetje, parashtruesi i kërkesës kishte deklaruar se ishte njoftuar nga personi V.M, pa saktësuar datën e pranimit të vendimit.
77. Gjykata rikujton se periudha prej 4 (katër) muajsh fillon të ecë që nga data në të cilën parashtruesi i kërkesës dhe/ose përfaqësuesi i tij apo i saj ka pranuar vendimin përfundimtar apo ka pasur dijeni të mjaftueshme për vendimin përfundimtar të gjykatave të rregullta (shih Vendimin e GJEDNJ-se *Koç dhe Tosun kundër Turqisë*, nr. 23852/04, të 13 nëntorit 2008, shih mes tjerash edhe rastet e Gjykatës: KI12/20, parashtruese: *Hamijete Dinarama-Daija* Aktvendim i 6 nëntorit 2020, paragrafi 38; KI45/21 parashtrues *Samedin Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 majit 2021, paragrafi 32).
78. Marrë parasysh praktikën e lartcekur, Gjykata rikujton se nuk ka informacion se kur saktësisht është njoftuar parashtruesi i kërkesës me përmbajtjen e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 4311/2019, megjithatë nga shkresat e lëndës Gjykata ka parasysh që Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 4311/2019, është tentuar të i dorëzohet parashtruesit të kërkesës dhe nuk kemi informacion se a është afishuar apo jo ky Aktvendim në tabelën e gjykatës. Megjithatë ajo çka është jo-kontestuese është që parashtruesi i kërkesës ka kërkuar shkresat e lëndës nga përmbaruesi privat më 14 dhjetor 2020. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se data 14 dhjetor 2020, konsiderohet data në të cilën fillon të rrjedhë afati dhe parashtruesi kërkesën e tij pranë Gjykatës e kishte dorëzuar më 22 shkurt 2021, brenda afatit prej 4 (katër) muajsh.
79. Megjithatë, përveç dispozitave të lartcekura, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës. Në mënyrë specifike, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

80. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”* të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtrues Sadik Gashi, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; dhe KI21/21, me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021).
81. Gjykata vëren se në formularin e parë të kërkesës pranë Gjykatës, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar pretendimet vetëm lidhur me procedurën e ndjekur nga Përmbaruesi Privat. Gjykata më 2 mars 2021, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës fletëkthesën që dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nrA311/2019 të 18 marsit 2020. Parashtruesi i kërkesës në përgjigjen e tij kishte theksuar se (i) ai nuk ka parashtruar asnjëherë ankesë në Gjykatën e Apelit dhe e njëjta përmban nënshkrimin e falsifikuar; (ii) dhe nuk ka pranuar asnjëherë fletëkthesë për pranimin e Aktvendimin të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 4311/2019, i nxjerrë më 18 mars 2020.
82. Gjykata rikujton se nga iniciativa për parashtrimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës kishte goditur specifikisht Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 4311/2019, të 18 marsit 2020, për çka vërtetohet se parashtruesi i kërkesës ka qenë në dijeni lidhur me Aktvendimin e kontestuar. Në këtë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë parashtruesi i kërkesës nuk kishte specifikuar këto pretendime. Rrjedhimisht, pretendimet e tij lidhur me falsifikimin e nënshkrimit dhe mos-paraqitjen e ankesës nga ana e parashtruesit, Gjykata i konsideron të pa bazuara.
83. Së dyti, Gjykata rikujton se në esencë parashtruesi i kërkesës pretendon që i është shkelur e drejta e tij kushtetuese (i) për barazi para ligjit sepse Përmbaruesi Privat nuk i ka trajtuar palët në procedurë njësoj, por i ka dhënë tretman të veçantë kreditorit; (ii) e drejta për mjete juridike sepse, parashtruesi i kërkesës thekson se atij iu është mohuar e drejta në mjetin juridik, përkundër

faktit që kreditori ka bërë propozim për zgjerimin e përmbarimit me 6 shkurt 2019, dhe për çka përmbaruesi nuk kishte marrë urdhër të ri; (iii) dhe e drejta për mbrojtje të pronës sepse Përmbaruesi Privat, ka shkelur procedurën e përmbarimit, me ç'rast ka ndërruar disa here parcelat përkatësisht pa marrë vendim adekuat lidhur me këto ndërrime dhe e shet të njëjtën për 1/3 e vlerës reale. Pra, në esencë parashtruesi i kërkesës ankohet për procedurat e ndjekura nga përmbaruesi privat, në procedurën përmbarimore.

84. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj, lidhur me shitjen e paluajtshmërisë kishte theksuar si në vijim:

“Urdhri për shitjen është i drejtë konform dispozitës së nenit 222 të LPP-së, ngase pasi të kryhet procedura për përcaktimin e vlerës së paluajtshmërisë, organi përmbarues jep konkluzion për shitjen e paluajtshmërisë me të cilin e cakton vlerën e paluajtshmërisë, mënyrën dhe kushtet e shitjes, si dhe kohën dhe vendin e shitjes, po që se shitja bëhet me ankand publik. Organi përmbarues konform nenit 223 të LPP-së, konkluzionin për shitjen e paluajtshmërisë e shpall në tabelën e organit përmbarues me vendimin e organit përmbarues dhe në mënyrë tjetër përkatëse. Mënyra e shitjes së paluajtshmërisë është rregulluar me nenin 227 të LPP-së, ku përcaktohet se shitja e paluajtshmërisë behet me ane të ankandit publik verbal, seanca për shitjen e paluajtshmërisë mbahet para organit përmbarues, në ndërtesën e organit përmbarues, në qoftë se organi përmbarues nuk ka caktuar vend tjetër të shitjes.

Çmimin për shitjen e paluajtshmërisë, organi përmbarues e cakton në seancën e parë të ankandit të shitjes së paluajtshmërisë, e cila shumë nuk mund të jetë nën 50% të vlerës së përcaktuar, e nëse paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet në seancën e parë, caktohet seanca e dytë ku paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmimin me të vogël se 1/3, e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë. Në rastin konkret shitja e paluajtshmërisë në seancën e ankandit të dytë publik në shumën prej 32,138.00 €, është në përputhje me 1/3 e vlerës së paluajtshmërisë të vlerësuar në shume prej 96,200.00 €, sipas ekspertizës së datës 26.07.2019, të ekspertit [H.I], i caktuar me Konkluzionin e përmbaruesit privat P.nr.543/2018 të datës 25.07.2019.

85. Nisur nga Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se ajo, i kishte sqaruar parashtruesit të kërkesës që (i) Urdhri për shitje është bërë konform nenit 222 të LPP-së; (ii) konform nenit 223 të LPP-së, organi përmbarues e shpall në tabelë konkluzionin për shitjen e paluajtshmërisë; (iii) bazuar në nenin 227 është e rregulluar mënyra e shitjes. Më pas, Gjykata e Apelit kishte sqaruar që shitja e paluajtshmërisë në seancën e ankandit të dytë, është në përputhje me 1/3 e vlerës së paluajtshmërisë.
86. Së dyti, Gjykata e Apelit lidhur me procedurat pranë përmbaruesit privat kishte theksuar që:

“Lidhur me pretendimin ankimor të debitorit "MS Finance" L.L.C, se i njëjti nuk ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e ankandit publik nga

përmbaruesi privat, kjo Gjykata vlerëson se në baze të shkresave të lëndës, përkatësisht nga fletëdërgesat për dorëzim personal, shihet se debitorit, është tentuar dy herë të i bëhet dorëzimi i konkluzioneve për mbajtjen e ankandit, dhe atë një herë me datë 16.05.2019, me ç'rast shkresa është kthyer për shkak se debitori nuk është gjendur aty dhe poashtu me datë 20.05.2019, kur është refuzuar pranimi pa ndonjë arsye, ashtu që në rastin konkret dorëzimi konsiderohet se është realizuar në rregull, konform dispozitës së nenit 112 të LPK -së.”

87. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit lidhur me pretendimin ankimor të parashtruesit të kërkesës se ai nuk ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e ankandit publik nga Përmbaruesi Privat, kishte theksuar se bazuar në shkresat e lëndës, konkretisht fletëkthesat për dorëzim personal, parashtruesit të kërkesës është tentuar dy herë t'i bëhet dorëzimi i konkluzioneve për mbajtjen e ankandit (i) një herë më 16 maj 2019, me ç'rast shkresa është kthyer sepse ai nuk është gjendur aty; dhe (ii) më 20 maj 2019, kur është refuzuar pranimi pa ndonjë arsye dhe që në rastin konkret, Gjykata e Apelit e konsideroi se dorëzimi është realizuar me rregull konform nenit 112 të LPK-së.
88. Gjykata gjithashtu rikujton se përgjatë procedurave, Përmbaruesi Privat kishte bërë korrigjimin e parcelave përkatëse, duke bërë zëvendësimin e tyre me paluajtshmërinë P-70403033-02444-9, paluatshmëri kjo e caktuar përmes Urdhrit Përmbarimor P.nr.543/18 më 25 mars 2019, përmes të cilit Urdhërohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Gjiilan të bëjë caktimin e shënimit të përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive të evidentuara në kadastër, përfshirë paluajtshmërinë në fjalë P-70403033-02444-9. Në ankandin publik lidhur me këtë paluajtshmëri, sipas edhe vetë arsyetimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës, ishte njoftuar me rregull. Nga shkresat e lëndës, vërehet se i njëjti ka munguar në çdo ankand.
89. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e Gjykatës së Apelit të shtjelluara më lart, konsideron se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit Ac.nr.4311/2019 i 18 marsit 2020 është nxjerrë duke arsyetuar lidhur me bazën ligjore për shitjen në ankand të paluajtshmërisë së parashtruesit të kërkesës P-70403033-02444-9 dhe duke u bazuar dispozitat e LPK-së, parashtruesi i kërkesës është ftuar me rregull. Për pasojë, Gjykata pretendimet e parashtruesit të kërkesës i konsideron qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese në *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.
90. Gjykata, në fund, rikujton se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
91. Prandaj dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me

paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 24 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani